



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

V E N D I M

Nr.166, datë 11.09.2019

PËR

SKUALIFIKIMIN DHE PËRJASHTIMIN E KANDIDATIT Z. {...} NGA PROCEDURA E EMËRIMIT NË GJYKATËN E LARTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 11.09.2019, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjëndjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit z. {...}”, përgatitur nga relatori z. Dritan Hallunaj, si dhe pasi shqyrtoi propozimin e tij,

V Ë R E N

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimet nr.108, 109, dhe 110 datë 09.07.2019, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, **Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur :**

I. Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës administrative (108), civile (109) dhe penale (110).

Çdo jurist, që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara ne nenin 136, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 1, 2 dhe 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për të marrë pjesë në këtë procedurë konkurrimi të hapur publike dhe të paraqesë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar më poshtë.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për t’u emëruar ne Gjykatën e Lartë, sipas nenit 136, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, janë :

- a) të ketë vjetërsi në profesion, prej 15 vjetësh, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës;

- b) të mbajë gradë shkencore në drejtësi;
- c) të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit.

Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara më sipër, duhet të plotësojë edhe kriteret, sipas nenit 48, pika 3, shkronja “c” dhe pika 5, si dhe nenit 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si mëposhtë :

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë shtetas shqiptar;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim penal të formës së prerë;
- ç) të mos jetë i larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- d) të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990;
- dh) të mos ketë qenë dhe të mos jetë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete,
- e) të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas ligjit.

Plotësimi i kushteve dhe kriterëve të mësipërme do të verifikohet sipas kërkesave dhe procedurës së përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”.

Kandidati që përmbush kushtet dhe kriteret e mësipërme, do të vlerësohet, pikëzohet dhe renditet sipas kërkesave dhe procedurës së përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 102, datë 05.07.2019, “Për kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”.

Në momentin e aplikimit **kandidati duhet të paraqesë këto dokumente :**

- a. Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për pozicionin e lirë, sipas kërkesave të shpallura;
- b) Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail);
- c) Fotokopje të kartës së identitetit;
- d) Dokumentacionin shoqërues nëpërmjet të cilit vërtetohet përmbushja e kushteve dhe kriterëve të përcaktuara më lart.

2. **Brenda afatit** dyjavor nga nga dita e publikimit të vendimeve si më lart në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, **për tre pozicionet e lira** të shpalluara përmes tre vendimeve si më lart, **ka aplikuar për të marrë pjesë edhe kandidati z. {...}**.

3. **Me Vendimin nr.142, datë 26.07.2019**, bazuar në nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), **Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur :**

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidatët, nga radhët e juristëve të spikatur, për në pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë.

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat që ka dorëzuar kërkesën për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë, si më poshtë:

...;

3. Për z. {...} relator z.Dritan Hallunaj;

...”.

4. **Më datë 26.07.2019**, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, **kandidati, z. {...}**, në rrugë elektronike, **është njoftuar : - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit**, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidati është njoftuar edhe për detyrimin për **plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit** ndaj tij, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

5. Brenda afatit tre ditor, kandidati, **z. {...}**, **ka depozituar rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik**, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij. Nga ana tjetër, në këtë afat, **kandidatit nuk ka parashtruar asnjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**

6. **Më datë 29.07.2019**, pas shqyrtimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur në rastin e kandidimit, duke vlerësuar se ky dokumentacion ishte i mangët apo jo konform ligjit (origjinal ose i njesuar me origjinalin), **kandidati, z. {...}**, në rrugë elektronike, **është njoftuar për plotësimin e dokumentacionit të kandidimit**, bazuar në pikën 9, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019.

7. **Po më datë 29.07.2019**, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatit, z. {...}, në rrugë elektronike, i janë **dërguar formularët dhe autorizimet përkatëse** (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

8. Brenda afatit, kandidati z. {...}, ka depozituar rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, **me përjashtim** të librezës së punës së kandidatit.

9. Në jetëshkrimin e dorëzuar nga ana e kandidatit, z. {...}, ai ka përshkruar si përvojë pune edhe atë të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, për periudhën 1999 – 2008.

10. Nisur nga sa më sipër nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor janë ndërmarrë disa verifikime duke u konsultuar me fletoret zyrtare, dhe rezultoi se në Fletoren Zyrtare nr.17, dalë nga botimi më datë 15.07.1999, ku është konstatuar se Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. {...}, datë {...}, në mbështetje të nenit 136, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të pëlqimit të dhënë nga Kuvendi me Vendimin nr. {...}, datë {...}, ka vendosur :

“Neni 1

Zoti {...} emërohet anëtar i Gjykatës së Lartë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë”.

11. Në vijim të procedurës së verifikimit, nga korrespondenca me Gjykatën e Lartë, sipas Shkresës nr. 2187/1 prot., datë 02.09.2019, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 4238/1 prot., datë 02.09.2019, ndërsa konfirmohet fakti i emërimit të **kandidatit, z. {...}** me dekretin e sipërpërmendur të Presidentit të Republikës, vërtetohet se ai ka ushtruar detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë deri më datë 21.05.2008, pra deri në përfundim të mandatit 9-vjeçar.

12. Mbi këtë bazë, **më datë 03.09.2019**, kandidati, z. {...}, në rrugë elektronike, **është njoftuar për gjetjen e procedurës së verifikimit**, pra në lidhje me faktin e qënijes një herë në këtë detyrë, si Gjyqtar i Gjykatës së Lartë, dhe është ftuar kandidati që të paraqesë shpjegime për gjetjen e procedurës së verifikimit, si edhe të çdo dokumentacion mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit tij.

13. Brenda afatit të caktuar, kandidati, z. {...}, **paraqiti shpjegimet e tij.**

14. Pas marrjes së shpjegimeve nga kandidati, z. {...}, duke vlerësuar të plota procedurën e verifikimit të ndjekur deri në këtë moment dhe, në veçanti, verifikimet në lidhje me **ekzistencën e kushtit ndalues** të kandidimit, ai i **“riemërimit gjyqtar në Gjykatën e Lartë”**, përcaktuar në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, mbi konsideratën se në rastin konkret verifikohet rrethanë që ishte e aftë për të passjellë skualifikimin e kandidatit nga procedura konkurruese publike, **relatori i çështjes ia parashtrroi rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.**

15. Në Mbledhjen e **datës 09.09.2019, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës**, duke konsideruar të plota procedurat dhe verifikimet për këtë kusht kandidimi për z. {...}, bazuar në pikën 3, të Seksionit C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, **vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për skualifikimin e kandidatit për ekzistencën e kushtit ndalues të kandidimit, ose për vijimin e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.**

II. GJETJA E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT DHE VLERËSIMI I SAJ

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor, vlerëson se gjetja e procedurës së verifikimit është një rrethanë faktike përmes të cilës vërtetohet se për kandidatin, z. {...}, verifikohet ekzistenca e kushtit ndalues të kandidimit, ai i “riemërimit gjyqtar në Gjykatën e Lartë”, përcaktuar në nenin 136 pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Sipas nenit 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, formulimit që ka qenë në fuqi në momentin e emërimit të tij si anëtar i Gjykatës së Lartë, “1. Anëtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit. ... 3. Kryetari dhe anëtarët e Gjykatës së Lartë qëndrojnë në detyrë për 9 vjet pa të drejtë riemërimi. ...”.

3. Ndërsa sipas nenit 136, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, formulimit aktual, pra në momentin e aplikimit të kandidatit z. {...}, për t’u emëruar si gjyqtar i Gjykatës së Lartë: “Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi”.

4. Referuar nenit 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, qoftë sipas formulimit në momentin e emërimit të kandidatit si anëtar (gjyqtar) i Gjykatës së Lartë, ashtu edhe sipas formulimit në momentin e aplikimit të kandidatit z. {...} për t’u emëruar si gjyqtar i Gjykatës së Lartë, gjyqtari i Gjykatës së Lartë nuk ka të drejtë të riemërohet.

5. Po ashtu, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson të plota procedurat dhe verifikimet për këtë kusht kandidimi për z. {...}.

III. PRETENDIMET E KANDIDATIT DHE VLERËSIMI I TYRE

1. Pas marrjes së njoftimit të dërguar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **kandidati z. {...}**, në rrugë elektronike me datë 05.09.2019, protokolluar me shkresën nr.3980/6 datë 06.09.2019, **ka parashtruar :**

“U vura në dijeni mbi pretendimin e parashtruar, se neni 136 i Kushtetutës përbën një kusht ndalues për kandidimin tim.

Lidhur me këtë po paraqes komentimin si më poshtë:

i.Është e saktë se ligjvënsi me përcaktimin e bërë në nenin 136 të Kushtetutës ka përcaktuar një normë ndaluese. Por për të saktësuar karakterin ndalues dmth. intensitetin e saj duhet të analizohet koha, subjekti që i nënshtrohet këtij ndalimi dhe organi që detyrohet në zbatimin e saj.

*ii.Neni 136 Kushtetutës përcaktonte se ... 3. Kryetari dhe anëtarët e Gjykatës së Lartë qëndrojnë në detyrë për 9 vjet pa të drejtë **riemërimi**. ...”. Pra veprimi i normës shtrihet mbi një subjekt të posaçëm që është Anëtar i Gjykatës së Lartë, duke legjitimuar kohëzgjatjen e emërimit të tij vetëm për një mandat. Norma nuk lejon **vazhdimësinë** e mandatit të Anëtarit të Gjykatës së Lartë. Në dallim me këtë kemi organe të tjera kushtetuese, në të cilat ligjvënsi ka lejuar parimin e*

vazhdimësisë së mandatit si psh. në rastin e Prokurorit të Përgjithshëm, Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit etj. Në këtë aspekt kufizimi i sanksionuar si më sipër vepron vetëm pasi ka filluar mandati përkatës dmth. subjekti është emëruar. Ky kufizim nuk shtrihet mbi të drejtën, që ka subjekti në cilësinë e kandidatit për postin e Anëtarit të Gjykatës së Lartë. Pra si subjekt i ndalimit është Anëtari i Gjykatës së Lartë dhe jo kandidati për këtë detyrë. Vetë termi **riemrim** tregon **vazhdimësi** të procesit dhe këtë vazhdimësi ligjvënsi nuk e dëshiron.

iii. Përfundimisht pengesa ka të bëjë vetëm **me vazhdimësinë** e mandatit të fituar rregullisht nga Anëtari Gjykatës së Lartë dhe jo me të drejtën për të konkuruar për një vend të tillë dmth. me ushtrimin e procedurës për tu emëruar në këtë detyrë. Kjo është e drejtë kushtetuese dhe ligjvënësi nuk mundet që të lejojë një kufizim të tillë. Unë e kam lënë mandatin në vitin 2008 dhe gjatë kësaj kohe kam patur aktivitet privat, pra nuk mundet të flitet për riemrim. Është e drejta e personit të konkurojë për një detyrë, nëse përmbush kriteret e përcaktuara. Në të kundërt do të ishim para diskriminimit profesional.

iv. I njëjti interpretim lejon të bëhet edhe duke ju referuar organit që zbaton këtë detyrim. Termi i përdorur është “riemërim” dmth. ky detyrim i referohet veprimtimit të Presidentit. Ligjvënësi nuk lejon që Presidenti të riemërojë një gjyqtar përsëri dmth. me një mandat tjetër. Kjo pengesë disiplinon veprimtarinë e Presidentit, i cili nuk mundet të zgjasë mandatin e një gjyqtari sipas dëshirës së tij. Kuptimi i kufizimit të riemërimit është, që për çdo rast kërkohet një vendim i Këshillit dhe më pas një emërim i Presidentit.

v. Ky konkluzion përforcohet edhe nga formulimet e tjera, që ligjvënsi i ka dhënë normave kushtetuese. Kështu nëse shohim nenin 88 të saj, kemi formulimin: Presidenti i Republikës, në çdo rast, zgjidhet për 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pra është e qartë se vazhdimësia e detyrës si President lejohet vetëm një herë, por nuk ka asnjë pengesë që pas kryerjes së një detyre tjetër ai të kandidojë përsëri si President. Si praktikë ndërkombëtare është shëmbulli rus, ku presidenti ka të drejtë të qëndrojë në detyrë vetëm dy mandate njeri pas tjetrit. Presidenti i sotem pas largimit si President qëndroj si Kryeministër dhe më pas u zgjodh përsëri President (Neni 81§ 3 Kushtetutës Ruse).

vi. Kufizimi i pretenduar është diskutuar edhe më parë dhe është arritur në përfundimin se përmbajtja e nenit 136 i referohet vetëm vazhdimësisë së mandatit dhe jo të drejtës për të kandiduar qoftë edhe përsëri për një post të tillë. Nëse kandidati pranohet nuk quhet riemërim por **quhet emrim** si Anëtar Gjykatës së Lartë. Ky është dallimi. Nëse ligjvënsi do të dëshironte të pengonte kandidimin për herë të dytë ai do të shprehej qartë, **nuk lejohet kandidimi për herë të dytë**.

vii. Kjo të çon në konkluzionin se termi riemërim i interpretuar si kusht ndalues për kandidimin si Anëtar i Gjykatës së Lartë, nuk mund të barazohet me qënien e kandidatit kohë më parë në këtë detyrë, por vetëm me vazhdimësinë e pandërprerë të detyrës së filluar. Vlen të përmendim në këtë rast praktikën e kandidimit të Z. Zamir PODA (u paraqit kandidatura për herë të dytë por nuk mori votat e duhura në Parlament) ose të Ztt. Spiro SPIRO (Anëtar i Gjykatës së Lartë për të dytën herë viti 2001) si dhe Metush SARACI (Anëtar i Gjykatës së Lartë për të dytën herë).

viii. Së fundi interpretimi i normës duhet të bëhet sipas kohës dhe në mënyrën më efektive, dmth që i vjen më afër qëllimit të saj, që nxit dhe i hap perspektivë asaj. Me ndryshimet e bëra, neni 136 përcakton një **mënyrë të re të rekrutimit** të Anëtarit të Gjykatës së Lartë. Qëllimi i normës është pikërisht rritja dhe forcimi sistemit të drejtësisë dhe profesionalizmit në dhënien e saj. Kështu përcaktohet se një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes **juristëve të spikator** me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të **nivelet të lartë** në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. Kandidatët që përzgjidhen nga radhët e juristëve duhet të kenë gradë shkencore në drejtësi.

ix. Norma kushtetuese në kohën e emërimit tim (viti 1998) nuk ka patur këtë frymë. Norma e sotme ka të përcaktuara kritere ligjore, të cilat janë të detyrueshme të respektohen. Vetë koncepti “**jurist i spikator**” e nënkupton dhe e pranon edhe qënien më parë si Anëtar i Gjykatës së Lartë (nivel i lartë i administratës publike). Për më tej kushti ndalues sot i referohet dy lloj subjekteve **gjyqtar dhe jo gjyqtar**. 4. Kandidati jo gjyqtar nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit. **Ky është i vetmi kusht ndalues për mua si kandidat jo gjyqtar.**

Përfundimisht jam i mendimit se termi riemërim në rastin e nenit 136 të Kushtetutës nuk duhet të përbëjë kusht ndalues për kandidimin tim, pasi si subjekt jo gjyqtar nuk parashikohet pengesë ushtrimi më parë i një detyre të tillë”.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor, vlerëson se gjetja e procedurës së verifikimit është një rrethanë faktike përmes të cilës vërtetohet se për kandidatin, z. {...}, verifikohet ekzistenca e kushtit ndalues të kandidimit, ai i “riemërimit gjyqtar në Gjykatën e Lartë”, përcaktuar në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Sipas nenit 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, formulimit që ka qenë në fuqi në momentin e emërimit të tij si anëtar i Gjykatës së Lartë, “**1. Anëtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit. ... 3. Kryetari dhe anëtarët e Gjykatës së Lartë qëndrojnë në detyrë për 9 vjet pa të drejtë riemërimi. ...**”.

4. Ndërsa sipas nenit 136, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, formulimit aktual, pra në momentin e aplikimit të kandidatit z. {...}, për t’u emëruar si gjyqtar i Gjykatës së Lartë: “**Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi**”.

5. Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson të pabazuar **pretendimin e kandidatit z. {...}** se riemërimi i interpretuar si kusht ndalues për kandidimin si Anëtar i Gjykatës së Lartë, nuk mund të barazohet me qënien e kandidatit kohë më parë në këtë detyrë, por vetëm me vazhdimësinë e pandërprerë të detyrës së filluar, nuk qëndron. **Referuar nenit 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, qoftë sipas formulimit në momentin e emërimit të kandidatit si anëtar (gjyqtar) i Gjykatës së Lartë (viti 1999), ashtu edhe sipas formulimit në momentin e aplikimit të kandidatit z. {...} për t’u emëruar si gjyqtar i Gjykatës së Lartë (viti 2019), **gjyqtari i Gjykatës së Lartë nuk ka të drejtë të riemërohet.**

6. Kushtetutbërësi, në rastin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, ka zgjedhur të ndaloje riemërimin e tij. Një gjë e tillë është përcaktuar në mënyrë të qartë dhe pa asnjë ekuivok. Nga ana tjetër, kushtetutbërësi, kur ka cmuar, por në mënyrë të shprehur ka parashikuar mundësinë e rizgjedhjes/riemërimit jo të menjëhershme të një funksionari të lartë publik. Kështu një rast i tillë është parashikimi i bërë në nenin 147 pika 10, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor e ushtrojnë detyrën me një kohë të plotë për një periudhë prej pesë vjetësh, **pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme..**”. Pra, kushtetutbërësi, përmes parashikimeve të shprehura në dispozita të vecanta të Kushtetutës, nuk ka lënë asnjë mundësi interpretimi, përkundrazi. Nisur nga kjo mund të thuhet se nëse kushtetutbërësi ka patur vullnetin për të lejuar riemërimin jo të menjëhershëm të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, atëherë ai, sikurse ka parashikuar për funksionarë të tjerë publikë, këtë vullnet do ta kishte materializuar në një mënyrë të ndryshme. Përderisa nuk e ka bërë, Këshilli i Lartë Gjyqësor cmon se vullneti i kushtetutbërësit ka qenë pikërisht ai i ndalimit të riemërimit përgjithnjë të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, vullnet të cilin Këshilli ka detyrimin ta respektojë.

7. Nuk qëndron dhe nuk mund të pranohet pretendimi i kandidatit, në funksion të pretendimit bazë, atij për ndalim të riemërimit të menjëhershëm, në lidhje me disa riemërimet të bëra nga Presidenti i Republikës dhe Kuvendi i Shqipërisë. Pavarësisht nga sa kandidati pretendon, si dhe pavarësisht interpretimeve që mund të jenë bërë nga këto organe në raste të vecanta, Këshilli i Lartë Gjyqësor cmon se është në përgjegjësinë e tij kushtetuese dhe ligjore të vlerësojë dhe vendosë për rastin e z. {...}. Po ashtu, Këshilli vlerëson se kandidati ka dështuar të provojë për qënien para të njëjtave rrethana të faktit dhe ligjit të zbatueshëm me rastet që ai referon.

IV. KONKLUZIONE

1. Sa më lart, **Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në konkluzionin se për kandidatin, z. {...}, verifikohet ekzistenca e kushtit ndalues të kandidimit, ai i “riemërimit gjyqtar në Gjykatën e Lartë”, përcaktuar në nenin 136 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, prandaj Këshilli është përpara rastit për të vendosur skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë.**

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson po ashtu se në rastin konkret **nuk është e nevojshme kryerja e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit për këtë kandidat**, përse kohë, sipas ligjit, **ekziston kushti ndalues** i kandidimit duke passjellë dhe skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 1, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pika 1 dhe 5, të nenit 49 në lidhje me pikat 4, shkronja “c” dhe 6, të nenit 32, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61, në shkronjën “a”, të nenit 86 dhe nenet 97, 98 dhe 100, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “e”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së

Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit z. {...} nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr.108, datë 09.07.2019, Vendimin nr.109, datë 09.07.2019 dhe Vendimin nr. 110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...}.
3. Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR